

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

Instituti i Evropës Juglindore
për Politika Shëndetësore dhe Sociale

Oda e Infermierëve, mësuesve dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Kosovska Medicinska Komora i Medicinskih Stručnjaka i Kosovës
Chamber of nurses, teachers and other health professionals of Kosovo

ARHIV ARCHIV ARCHIVE

Nr. Prot. 603	Nr. i faq. -3-	Data: 28.06.2015
Broj. prot.	Br. str.	Datum
Prot. no	No. strana	Date

PRISTINE PRISTINA PRISTINA



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET INSTITUTIT TË EUROPËS JUGLINDORE PËR POLITIKA SHËNDETËSORE DHE SOCIALE DHE ODËS SE INFERMIERËVE TË KOSOVËS

Në emër të Odës së Infermierëve të Kosovës (OIK) dhe të Institutit të Evropës Juglindore për Politika Shëndetësore dhe Sociale, ne përfaqësuesit e institucioneve të sipërpërmendura, deklarojmë bashkëpunimin ndërinstitucional midis dy Institucioneve.

Qëllimi i marrëveshjes

Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të lartpërmendura ka për qëllim favorizimin e veprimeve sinergjike në avancimin e shërbimeve shëndetësore dhe infermierore në Kosovë duke mbështetur avancimin e cilësisë dhe implementimin e standardeve moderne në Shëndetësi.

Fushat e bashkëpunimit

OIK, respektivisht, IEJ-PSHS përcaktojnë në bazë të kësaj marrëveshje, fushat e bashkëpunimit siç vijon:

- Mbështetja, zhvillimi dhe forcimi i shkencave shëndetësore dhe infermierore në Kosovë përmes bashkëpunimit dhe bashkërenditjes së aktiviteteve me institucione të tjera që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë.
- Mbështetja, zhvillimi dhe përmirësimi i edukimit të vazhdueshëm profesional, atij universitar dhe pasuniversitar në lëmitë shëndetësore, në bashkëpunim e bashkëveprim me institucionet përkatëse të arsimit të mesëm dhe atij të lartë dhe integritit teori-praktikë.
- Ofrimi i konsulencës profesionale dhe bashkëpunimi me organizma institucionale sipas marrëveshjeve përkatëse.
- Nxitja dhe lehtësimi i bashkëpunimit ndërdisciplinor.
- Organizimi i trajnimeve me tematika të ndryshme të karakterit shkencor apo kualifikues brenda dhe jashtë Kosovës.
- Mbështetje dhe zhvillim të promovimit të shëndetit përmes aktiviteteve integruese dhe multidisciplinare të të gjitha kategorive sociale.
- Organizimi i konferencave, simpoziumeve, workshopeve dhe tryezave të ekspertëve.
- Organizimi i kurseve të shkurtëra.



Neni 1: Objektivat

Aktivitetet e planifikuara për vitin 2019

- Simpoziumi i datave 13-14 Shtator 2019.
- Workshope te Simpoziumit të datave 12 Shtator 2019.
- Kurse/workshope të Shkurtëra 01.07.2019

Neni 2: Aktivitetet

Çdo propozim për aktivitete duhet të aprovet paraprakisht nga të dy institucionet. Pasi të pranohet propozimi, të dy institucionet caktojnë personat përgjegjës për zbatimin e aktivitetit.

Shtrirja e aktiviteteve:

Arritjen e objektivave të definuara nga kjo marrëveshje pretendohet të arrihen përmes shtrirjes së aktiviteteve të përbashkëta ndërinstitucionale (OIK, respektivisht, IEJ-PSHS).

Kapacitetet:

IEJ-PSHS tani më posedon një traditë të larmishme të punës shkencore në Kosovë dhe rajon duke realizuar me sukses të lartë një mori projektsh me institucione dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare. Përmes rrjetit të tij të bashkëpunëtorëve të Universiteteve të rajonit (Tiranë, Vlorë, Tetovë, Prishtinë) dhe atyre në shtetet e Evropës së Bashkuar (Halle, München dhe Münster të Gjermanisë, Hall të Austrisë, Bern të Zvicrës dhe së fundi edhe Parisit në Francë) si dhe punëtorëve të brendshëm shkencor, të organizuar në zyrën qendrore në Prishtinë, IEJ-PSHS ofron një kapacitet të konsiderueshëm shkencorë dhe kadrovik. Kapacitetet e tilla humane me ekspertë më të spikatur vendor dhe rajonal si dhe forma e organizimit të punës, me një ndërlidhje dhe kooperim tejet intensiv me qendra ndërkombëtare me reputacion të lartë shkencor, na ofrojnë rrethana tejet të favorshme për realizimin e synimeve dhe përgjegjësisive që parasheh kjo marrëveshje.

Neni 3: Forma e bashkëpunimit

Të dy Institucionet caktojnë numrin e personave, qëllimi dhe kushtet e bashkëpunimit, të cilat do të përcaktohen mbi baza vjetore në përputhje me buxhetin e disponueshëm dhe do të përfshihen në programet vjetore të dy institucioneve.

Neni 4: Kohëzgjatja e marrëveshjes

Marrëveshja e tanishme bëhet për vitin 2019 nga data e nënshkrimit. Ligjërisht është e vlefshme prej momentit të nënshkrimit të saj nga të dyja palët. Marrëveshja mund të përfundojë me




iniciativën e cilës do palë në çdo moment. Në rast të anulimit apo mos vazhimit të marrëveshjes, institucionet bashkëpunuese dakordohen për përfundimin e suksesshëm të aktiviteteve të filluara.

Për Institutin e Evropës Juglindore për
Politika Shëndetësore dhe Sociale
(IEJ-PSHS)

Për:

Z. Petrit Beqiri

(Udhëheqës IEJ-PSHS)



Për Oden e Infermierëve, Mamive dhe
Profesionistëve Shëndetësor të Kosovës
(OIK)

Z. Naser Rrustemaj

Kryetar

